

20222032858

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

I HUAMARRJES TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA NGA BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE NË KUADËR TË MARRËVESHJES FINANCIARE PËR PROJEKTIN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS UJORE KOMUNALE NË MAQEDONINË E VERIUT

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Europiane e Investimeve në vlerë prej 50.000.000 euro, me qëllim të financimit të Projektit të përmirësimit të infrastrukturës ujore komunale në Maqedoninë e Veriut.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen financiare për Projektin e përmirësimit të infrastrukturës së ujit në komnat e Republikës së Maqedonisë, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Europiane të Investimeve.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen financiare të paragrafit 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të tërhiqet në më së shumti 20 këste. Vlera minimale e një kësti është 2.000.000 euro.

Norma e interesit do të përcaktohet për çdo këst të huas veçmas, në ditën e dorëzimit nga Ministria e Financave të kërkesës për tërheqje të mjeteve të huas, varësisht se cila normë e interesit është më e favorshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut (fikse ose variabile).

Afati për pagesën e çdo kësti të huas mund të jetë së paku katër vjet deri në 25 vjet nga dita e tërheqjes së këstit, me grejs periudhë të përfshirë që mund të jetë ndërmjet 30 ditëve dhe pesë vjetëve nga dita e tërheqjes së këstit.

Afati i pagesës së çdo kësti do të përcaktohet për çdo këst, veçmas, në ditën e dorëzimit nga Ministria e Financave të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas.

Kësti mund të paguhet gjithashtu një herë në ditën që është ndërmjet tre deri në 15 vjet nga dita e tërheqjes së këstit.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Investimeve provizion të njëhershëm në vlerë prej 30.000 eurove.

Neni 4

Projekti do të zbatohet nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor.

Neni 5

Shfrytëzuesit e fundit të mjeteve të huas së nenit 1 të këtij ligji janë komnat dhe komnat në qytetin e Shkupit, të cilat mjetet do t'i marrin si donacion.

Shpërndarja e mjeteve të huas së nenit 1 të këtij ligji do të bëhet në bazë të Vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare sipas Marrëveshjes financiare për Projektin e përmirësimit të infrastrukturës së ujit në komnat e Maqedonisë së Veriut, marrë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor do të lidhë Marrëveshje donacioni me secilën komunë.

Neni 6

Republika e Maqedonisë së Veriut do ta paguajë huan e nenit 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.